

SI TË APLIKONI PËR USHQIM FALAS APO ME ÇMIM TË REDUKTUAR NË SHKOLLË

Ju lutem përdorni këto udhëzime për t'ju ndihmuar të plotësoni aplikimin për ushqim falas ose të me çmim të reduktuar në shkollë. Ju duhet të dërgoni vetëm një aplikim për familje, edhe në goftë se fëmijët tuaj shkojnë në më shumë se një shkollë Putnam Valley Central School District. Aplikimi duhet të plotësohet tërësisht për të kandiduar fëmijët tuaj për ushqim falas ose me çmim të reduktuar në shkollë. Ju lutemi ndiqni këto udhëzime me radhë! Çdo hap i udhëzimeve është i njëjtë me hapat në aplikimin tuaj. Çdo herë që ju nuk jeni të sigurtë se çfarë duhet të bëni më tej, ju lutemi kontaktoni Valerie Aleman; 845-528-8130 x 1318, valeman@pvcasd.org.

JU LUTEMI PËRDORNI STIOLAPS (JO LAPS) KUR PLOTËSONI APLIKIMIN DHE PËRPIQUNI QË TË SHKRUANI SA MË QARTË.

HAPI 1: RENDISNI TË GJITHË ANËTARËT E FAMILJES TË CILËT JANË FOSHNJË, FËMIJË DHE NXËNËS DERI DHE PËRFSHI KLASËN 12

Na tregoni se sa foshnje, fëmijë dhe nxënës shkolle jetojnë në shtëpinë tuaj. Ata NUK DUHET të jenë patjetër të lidhur drejtpërdrejt me ju që të mund jenë pjesë e familjes tuaj.

Kë duhet të radhis në këtë listë? Kur të plotësoni këtë seksion, ju lutemi të përfshini TË GJITHË anëtarët e familjes tuaj të cilët janë:

- Fëmijë të moshës 18 vjeç e poshtë DHE që mbështeten me të ardhurat e ekonomisë familjare;
- Nën kujdesin tuaj sipas një marrëveshjeje kujdestarie, ose që kualifikohen si të pastrehë, emigrantë apo të rinj të larguar nga shtëpia;
- Studentë që ndjekin Putnam Valley Central School District, pavarësisht nga mosha.

A) Rendisni emrin e secilit fëmijë. Shkruani emrin e secilit fëmijë. Përdorni një linjë të aplikimit për çdo fëmijë. Kur shkruani emrat, vendosni një gërmë në çdo kuadrat. Ndaloni në goftë se nuk keni më vend për të shkruar. Nëse keni më shumë fëmijë të pranishëm se linjat në aplikim, bashkangjitni një letër tjetër shtesë me të gjitha të dhënat e nevojshme për fëmijët shtesë.

B) A është fëmija nxënës në Putnam Valley Central School District? Skruani 'Po' ose 'Jo' nën kolonën me titull "Nxënës", për të na treguar që fëmijët frekuentojnë Putnam Valley Central School District Nëse keni shënuar 'Po,' shkruani klasën e nxënësit në kolonën 'Klasa' në të djathtë.

C) A keni ndonjë fëmijë nën kujdestari? Nëse ndonjë nga fëmijët e listuar është fëmijë nën kujdestarinë tuaj, shënoni "Fëmijë nën kujdestari" në kuadratin pranë emrit të fëmijës. Nëse jeni duke aplikuar VETËM për fëmijë nën kujdestari, pasi mbaroni me **HAPIN 1**, shkoni te **HAPI 4**. Fëmijët nën kujdestari që jetojnë me ju, mund të llogariten si anëtarë të familjes suaj dhe duhet të renditen në aplikimin tuaj. Nëse ju aplikoni si për fëmijët tuaj ashtu edhe për ata nën kujdestari, shkoni te hapi 3.

D) A është ndonjë nga fëmijët i pastrehë, emigrant apo i larguar nga shtëpia? Nëse besoni se çdo fëmijë i renditur në këtë seksion plotëson këtë përshkrim, shënoni "I pastrehë, emigrant, i larguar nga shtëpia" në kuadratin pranë emrit të fëmijës dhe plotësoni të gjitha hapat e aplikimit.

HAPI 2: A KA NDONJË NGA ANËTARËT E FAMILJES QË AKTUALISHT MERR PJESË NË PROGRAMIN SNAP, TANF APO FDPIR?

Nëse dikush nga anëtarët e familjes tuaj (përfshi edhe ju) aktualisht merr pjesë në një ose më shumë nga programet e ndihmës të renditura më poshtë, fëmijët tuaj kanë të drejtë për ushqim falas në shkollë:

- Programi i Ndihmës me Ushqim Suplementar (SNAP) ose o 1-800-342-3009.
- Ndihma e Përkohshme për Familjet në Nevojë (TANF) ose 1-800-342-3009.
- Programi i Shpërndarjes së Ushqimeve në Rezervatet Indiane (FDPIR).

A) Në goftë se askush nga familja juaj nuk merr pjesë në ndonjë prej programeve të renditura më sipër:

- Lereni **HAPI 2** bosh dhe shkoni te **HAPI 3**.

B) Në goftë se dikush në familjen tuaj merr pjesë në ndonjë prej programeve të renditura më sipër:

- Shkruani numrin e rastit për SNAP, TANF ose FDPIR. Ju duhet të jepni vetëm një numër të rastit specifik. Nëse ju merrni pjesë në një nga këto programe dhe nuk e dini numrin e rastit tuaj, kontaktoni 518-473-1090.
- Shko te **HAPI 4**.

HAPI 3: RAPORTI I TË ARDHURAVE PËR TË GJITHË ANËTARËT E FAMILJES

Si mund të raportoj të ardhurat e mia?

- Përdorni tabelat me titull "**Burimet e të ardhurave për të rriturit**" dhe "**Burimet e të ardhurave për fëmijët**", që ndodhen në pjesën e pasme të formularit të aplikimit për të përcaktuar nëse familja juaj ka të ardhura për të raportuar.
- Raportoni të gjitha shumat VETEM NË TË ARDHURA BRUTO. Raportoni të gjitha të ardhurat në dollarë të plotë. Mos përfshini edhe centët.
 - Të ardhurat bruto janë të ardhurat totale të marra para tatimit
 - Shumë njerëz mendojnë se të ardhurat janë ato shuma "që merren në shtëpi" dhe jo totali i përgjithshëm, shuma "bruto". Sigurohuni që të ardhurat që ju raportoni në këtë aplikim NUK janë reduktuar për të paguar taksat, sigurimet, apo ndonjë shumë tjetër që është marrë nga paga juaj.
- Shkruani një "0" në çdo fushë ku nuk ka të ardhura për të raportuar. Çdo fushë për të ardhurat e mbetur bosh ose e pa shkruar do të llogaritet si zero. Nëse ju shkruani '0' ose lini një fushë bosh, ju po vërtetoni (premtoni) se atje nuk ka të ardhura për të raportuar. Nëse zyrtarët lokalë dyshojnë se të ardhurat e familjes suaj janë raportuar gabimisht, aplikimi juaj do të hetohet.
- Shënoni sa shpesh çdo lloj i të ardhurave është marrë duke përdorur kutitë në të djathtë të secilës fushë.

3.A. RAPORTONI TË ARDHURAT E FITUARA NGA FËMIJËT

A) Raportoni të gjitha të ardhurat e fituara ose të marra nga fëmijët. Raportoni të ardhurat e kombinuara bruto për TË GJITHË fëmijët e renditur te HAPI 1 në familjen tuaj në kutinë e shënuar "Të Ardhurat Totale të Fëmijëve." Llogarisni vetëm të ardhurat e fëmijëve nën kujdestari, nëse ju po aplikoni për ta së bashku me pjesën tjetër të familjes tuaj.

Çfarë janë të ardhurat e fëmijëve? Të ardhurat e fëmijëve janë paratë e marra nga jashtë familjes suaj që janë paguar DIREKT për fëmijët tuaj. Shumë familje nuk kanë asnjë të ardhur të fëmijëve.

3.B RAPORTONI TË ARDHURAT E FITUARA NGA TË RRRITURIT

Kë duhet të rendis këtu?

- Kur plotësoni këtë seksion, ju lutemi të përfshini TË GJITHË anëtarët e rritur të familjes që jetojnë me ju dhe ndajnë të ardhurat dhe shpenzimet, edhe në qoftë se ata nuk janë të lidhur drejtpërdrejt me ju dhe madje edhe në qoftë se ata nuk kanë të ardhurat e tyre.
- **MOS përfshini:**
 - Njerëzit që jetojnë me ju, por që nuk janë të mbështetur nga të ardhurat e familjes suaj DHE që nuk kontribuojnë me të ardhura për familjen tuaj.
 - Fëmijët dhe studentët tashmë të renditur te **HAPI 1**.

a) Rendisni emrat e anëtarëve të rritur të familjes. Shkruani emrin e çdo anëtari të familjes në kutitë e shënuara "Emrat e anëtarëve të rritur të familjes (Emri dhe mbiemri)." Mos rendisni asnjë anëtar të familjes që renditet te HAPI 1. Nëse një fëmijë i renditur te **HAPI 1** ka të ardhura, ndiqni udhëzimet në **HAPI 3, pjesa A**.

b) Raportoni të ardhurat nga puna. Raportoni të gjitha të ardhurat nga puna në fushën "Fitimet nga Puna" në aplikim. Këto janë zakonisht paratë e marra nga punë të ndryshme. Nëse ju jeni i vetë-punësuar në biznesin tuaj apo pronar ferme, ju do të raportoni të ardhurat neto.

Ç'ndodh nëse unë jam i vetë-punësuar? Raportoni i të ardhurave nga kjo punë si një sasi neto. Kjo llogaritet duke zbritur shpenzimet totale operative të biznesit tuaj nga faturat e saj ose të ardhurat bruto.

c) Raportoni të ardhurat nga asistenca publike / mbështetja e fëmijëve / mbështetja për ushqime. Raportoni të gjitha të ardhurat e duhura në fushën e aplikimit "Asistenca publike / Mbështetja e fëmijëve/Mbështetja për ushqime". Mos raportoni vlerën e parave të përfitimeve të asistencës publike që NUK janë renditur në tabelë. Nëse keni të ardhura nga mbështetja e fëmijëve apo mbështetja për ushqime, raportoni vetëm pagesat e urdhëruara nga gjykata. Pagesat informale por të rregullta duhet të raportohen si të ardhurat të "tjera" në pjesën që vijon.

d) Raportoni të ardhurat nga pensionet / dalja në pension / të gjitha të ardhurat e tjera. Raportoni të gjitha të ardhurat që duhet në fushën e aplikimit "Pensionet / Dalja në pension / Të gjitha të ardhurat e tjera".

e) Raportoni madhësinë totale të familjes. Shkruani numrin e përgjithshëm të anëtarëve të familjes në fushën "Numri total i anëtarëve të familjes (Fëmijë dhe të rritur)." Ky numër DUHET të jetë i barabartë me numrin e anëtarëve të familjes të renditur te **HAPI 1** dhe **HAPI 3**. Nëse ka ndonjë anëtar të familjes tuaj që ju nuk e keni renditur në aplikim, shkoni mbrapa që të shtoni edhe ata. Është shumë e rëndësishme që të rendisni të gjithë anëtarët e familjes, sepse madhësia e familjes suaj ndikon në të drejtën për ushqim falas ose me çmim të reduktuar.

f) Shkruani katër shifrat e fundit të Numrit tuaj të Sigurimeve Shoqërore. Një anëtar i rritur i familjes duhet të shkruajë katër shifrat e fundit të Numrit të Sigurimeve Shoqërore në hapësirën e caktuar. Ju keni të drejtë të aplikoni për përfitime edhe nëse ju nuk keni një Numr të Sigurimeve Shoqërore. Nëse asnjë nga anëtarët e rritur të familjes nuk ka Numër të Sigurimeve Shoqërore, lini këtë hapësirë bosh dhe shënoni në kutinë në të djathtë të emërtuar "Shënoni nëse nuk keni SS#."

HAPI 4: INFORMACIONI I KONTAKTIT DHE NËNSHKRIMI I TË RRITURVE

Të gjitha aplikimet duhet të nënshkruhen nga një anëtar i rritur i familjes. Duke nënshkruar aplikimin, ai anëtar i familjes po premtan se i gjithë informacioni është raportuar me ndershmëri dhe tërësisht. Para përfundimit të këtij seksioni, ju lutemi sigurohuni që keni lexuar deklaratat e privatësisë dhe të të drejtave civile në pjesën e pasme të aplikimit.

A) Shkruani informacionin e kontaktit tuaj. Shkruani adresën tuaj të tanishme në fushat e caktuara në qoftë se ky informacion dihet. Nëse nuk keni adresë të përhershme, kjo nuk do të bëjë që fëmijët tuaj të humbin të drejtën për ushqim falas ose me çmim të reduktuar në shkollë. Dhënia e një numri telefoni, adrese e-mail, ose të dyja bashkë, është fakultative, por na ndihmon të arrijmë që t'ju kontaktojmë shpejt në qoftë se kemi nevojë për ju.

B) Shkruani dhe nënshkruani emrin tuaj. Shkruani emrin e personit të rritur që nënshkruan aplikimin dhe ai person firmos në kutin e "Nënshkrimi i të rriturit".

C) Shkruani datën e sotme. Në hapësirën e dhënë, shkruani datën e sotme.

D) Shkruani identitetet racore dhe etnike të fëmijëve (opcionale). Në pjesën e pasme të aplikimit, ne ju kërkohet që të jepni informacion në lidhje me racën dhe etninë e fëmijëve tuaj. Kjo fushë është opcionale dhe nuk ndikon në të drejtën e fëmijëve tuaj për ushqim falas ose me çmime të reduktuara në shkollë.